



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1854 prot.

Tiranë, më 14.6. 2018

Lënda: Mbi raportet e monitorimit për periudhën janar - prill 2018

MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
DREJTORISË SË ANALIZAVE DHE POLITIKAVE BUXHETORE

Blv. "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si organ i sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim garantimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësisë në sistemin e drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 84/2016, neni 19, institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve zbatojnë në mënyrë të pavarur buxhetin e tyre të miratuar nga Kuvendi.

Në kuadër të pavarësisë në menaxhimin e buxhetit, por edhe në respekt të transparencës së përdorimit të fondeve buxhetore, bazuar në ligjin nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore" si dhe udhëzimin plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 19.1.2018, "Për zbatimin e buxhetit për vitin 2018", në vijim ju paraqesim një analizë të përdorimit të fondeve buxhetore për 4-mujorin e parë të vitit 2018, për Institucionin e Komisionerëve Publikë.

Lidhur me metodologjinë e raportimit të përcaktuar në udhëzim, dëshirojmë të shpjegojmë se kjo metodologji nuk është zbatuar në buxhetin e institucionit tonë për vitin 2018, meqenëse viti korrent është viti i parë i fillimit të aktivitetit të plotë vjetor të tij dhe parashikimi i këtij buxheti nuk është bërë në bazë produkti. Në këto kushte e kemi të pamundur të kryejmë një analizë mbi këtë bazë.

Për efekt analize dhe monitorimi, në këtë moment që jemi, kemi përcaktuar veprimtarinë vjetore të institucionit si produkti kryesor dhe kemi analizuar realizimin për 4-mujorin e parë të vitit 2018, për shpenzimet korrente për këtë produkt të përgjithshëm. Gjithashtu kemi identifikuar disa produkte që do të realizohen me buxhetin në shpenzimet kapitale.

Në mungesë të eksperiencave të mëparshme, gjykojmë se në përfundim të vitit 2018 do të mund të kemi një vlerësim të plotë mbi ecurinë dhe trendin e numrit të çështjeve që do të shqyrtohen, me qëllim përcaktimin e tyre si produktin kryesor të ofruar. Gjithsesi, finalizimi me sukses i procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë do të jetë produkti themelor, i prekshëm e i matshëm, në përfundim të këtij procesi.

Në tabelën në vijim ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur të dhëna mbi buxhetin e miratuar dhe realizimin sipas artikujve.

000/lekë				
Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor Plani	Buxheti vjetor Plani 4-mujor/progresiv	Realizimi Fakti 4-mujor/progresiv
600+601	Paga dhe sigurime	54,200	20,000	5,729
602	Shpenzime për mallra dhe shërbime	4,000	1,600	265
231	Shpenzime kapitale	9,000	9,000	0
	TOTALI	67,200	30,600	5,994

Në mënyrë analitike, performanca e objektivave dhe e realizimit të shpenzimeve për 4-mujorin e parë të vitit 2018, për Institucionin e Komisionerëve Publikë paraqitet në vijim.

Aneksi nr. 1 - Raporti i shpenzimeve sipas programeve, për periudhën janar-prill 2018, është si më poshtë:

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2018, i cili përfshin shpenzimet operative dhe shpenzimet kapitale, për programin buxhetor 03360 është: 67,200 mijë lekë dhe buxheti i planifikuar për 4-mujorin e parë 2018 është: 30,600 mijë lekë. Realizimi i shpenzimeve për këtë periudhë është: 5,994 mijë lekë.

Aneksi nr. 2 - Raporti i shpenzimeve të programeve, sipas artikujve për 4-mujorin e parë 2018

Fondi vjetor i miratuar është: 67,200 mijë lekë, i ndarë në 58,200 mijë lekë për shpenzime korrente dhe 9,000 mijë lekë për shpenzime kapitale. Sipas artikujve, analiza paraqitet në vijim.

- 1. Artikulli 600 dhe 601, "Shpenzime personeli".** Buxheti vjetor i miratuar është 54,200 mijë lekë. Për 4 -mujorin e parë, plani për këtë artikull është: 20,000 mijë lekë dhe realizimi faktik i shpenzimeve është: 5,729 mijë lekë. Gjatë këtij 4-mujori,

nuk është përdorur i plotë fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore sipas detajimit në fillim të vitit, për shkak të mosplotësimit të strukturave organike. Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2018 (**26 veta**), nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij. Gjatë kësaj periudhe ka patur mungesa mesatarisht me 15 punonjës (**numri faktik 11**). Dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se plotësimi i strukturave organike të miratuara nuk është realizuar gjatë kësaj periudhe për shkak të kohës së nevojshme ligjore të procedurave të rekrutimit të stafit.

2. **Artikulli 602**, “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*”. Buxheti i miratuar në këtë artikull për vitin 2018 është: 4,000 mijë lekë dhe për 4-mujorin e parë është: 1,600 mijë lekë. Realizimi është 265 mijë lekë.

Në dokumentin e projektbuxhetit për periudhën 2019-2021, ju kemi parashtruar situatën e pamjaftueshmërisë së fondeve në shpenzime operative për vitin 2018 në funksion të aktivitetit të tij vjetor. Gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2018, ky institucion ka ushtruar aktivitetin pranë zyrave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe është asistuar prej tij me furnizimin e të gjithë bazës materiale të nevojshme. Në këto kushte, për 4-mujorin e parë të vitit nuk është kryer asnjë shpenzim nga fondet buxhetore të miratuara në shpenzime operative. Edhe në këtë situatë, buxheti në dispozicion prej 4,000 mijë lekë, nuk mbulon të plotë nevojat për pjesën e mbetur të vitit, maj-dhjetor 2018. Duhet marrë në konsideratë edhe fakti që institucioni nuk ka asnjë bazë materiale të trashëguar nga viti i mëparshëm.

Përveç kësaj, Institucioni i Komisionerëve Publikë, në fillim të muajit qershor, është akomoduar në katin e dytë të ish-godinës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, e cila është rikonstruktuar nga Ministria e Drejtësisë. Ky fakt nuk ka qenë i parashikuar në buxhetin për vitin 2018, duke qenë se në kohën e përgatitjes së tij institucionet kanë qenë në negociata për përcaktimin e ambienteve ku do të ushtronte aktivitetin Institucioni i Komisionerëve Publikë. Tashmë, situata është e qartë, institucioni është akomoduar në ambientet e reja të rikonstruara për këtë qëllim dhe vazhdon plotësimi i strukturave organike. Për pasojë janë shtuar shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzime funksionimi dhe mirëmbajtje të godinës, si dhe shpenzime e materiale të përgjithshme zyre, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në buxhetin e vitit 2018.

Për këtë arsye, në mbështetje të kërkesës së institucionit tonë, është alokuar në muajin maj 2018 një fond shtesë prej **2,500 mijë lekë** për shpenzimet operative.

Gjithashtu, mungesa e stafit të nevojshëm administrativ ka shkaktuar vonesa në prokurime në mallra e shërbime, situatë e cila është përmirësuar gjatë muajit qershor, me fillimin e plotësimit të strukturave mbështetëse të institucionit.

Në përfundim, dëshirojmë të theksojmë se mosrealizimi i fondeve në 4-mujorin e parë, sikurse u shpjegua, ka ardhur për shkaqe objektive, por kjo nuk do të ndikojë në performancën e këtyre shpenzimeve në 4-mujorin e dytë dhe në vazhdim për gjithë vitin 2018.

3. **Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”** për këtë program, është: **9,000 mijë lekë**. Realizimi faktik i shpenzimeve në investime për 4-mujorin e parë të vitit 2018 është: **0 lekë**, për arsyet e përmendura më lart. Fondi i investimeve i miratuar për vitin 2018 është çngurtësuar nga Ministria e Financave në datë 8.5.2018 dhe do të përdoret nga institucioni në vazhdim të veprimtarisë së tij, sipas detajimit të projekteve të miratuara dhe Regjistrin të Parashikimit të Prokurimeve.

Bashkëlidhur gjeni tabelat shoqëruese të raportit të monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2018.

Duke ju falënderuar,

KOMISIONERËT PUBLIKË

Florian Ballhysa

Darjel Sina





Konceptoi: A. Kastrati
Miratoi: A. Çeli

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke



Emri i Grupit		Komisioneret Publike				Kodi i Grupit		63	
Programet		Shpenzimet e Institucionit							
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2017	(2) PBA Viti 2018	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2018	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2018	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 4 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
0001	Veprimtaria vjetore e Institucionit	0.0	0	67,200.0	67,200.0	30,600.0	5,994.0	-24,606.0	
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		0.00	0	67,200.0	67,200.0	30,600.0	5,994.0	-24,606.0	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit					-				
Totali		0.00	0.0	67,200.0	67,200.0	30,600.0	5,994.0	-24,606.0	

Nëpunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Nëpunësi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	13.06.2018		Data	13.6.2018

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit	Komisionerët Publikë						Kodi i Grupit	63
Programi	Veprimtaria vjetore e Institucionit						Kodi i Programit	03360
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2017	(2) PBA Plan Viti 2018	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar viti korrent 2018	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2018	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 4 muajore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga			49,400	49,400	18,000	5,330	-12,670
601	Sigurime Shoqërore			4,800	4,800	2,000	399	-1,601
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera			4,000	4,000	1,600	265	-1,335
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja					0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ					0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	0.0	0.0	58,200	58,200	21,600	5,994	-15,606
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0.0	9,000	9,000	9,000	0	-9,000
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0.0	0.0	9,000	9,000	9,000	0	-9,000
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0.0	0.0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	0.0	0.0	9,000	9,000	9,000	0	-9,000
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti						0	
otall (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.Jashte llimit		0.0	0.0	67,200	67,200	30,600	5,994	-24,606

Nëpunësi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Nëpunësi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	13.6.2018		Data	13.6.2018

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Komisionerët Publikë	63
Programi	Veprimtaria vjetore e Institucionit	3360



Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit 2017)	Shpenzimet (sipas vitit 2017)	I		II		Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit 2018)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit 2018)	III		Sasia Faktikeper 4 mujorin e pare te vitit 2018	Shpenzimet Faktike per 4 mujorin e pare te vitit 2018	Kosto per Njesi per 4 mujorin e pare te vitit 2018	Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente
					Kosto per Njesi (sipas vitit 2017)	Sasia (sipas planit te vitit 2018)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2018)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit 2018)			V = IV - I	V = IV - II				V = IV - III			
Produkti A	Veprimtaria vjetore e Institucionit	nr. Institucionit	1	0	1	67,200	67,200	1	67,200	67,200	1	5,993	5,993	-91%	-91%			

Nëpunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Nëpunësi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	13.06.2018		Data	13.6.2018

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikese se programit"

Periudha e Raportimit: 4 mujori pare 2018

Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit:	Veprimtaria e komisionerit publik						Komente
Qellimi 1	Garantimi i funksionimit te shtetit te se drejtes, pavaresine e sistemit te drejtesise si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi		Mbeshtetja buxhetore dhe krijimi I kushteve optimale, pajisja me infrastrukturen e nevojshme,per ushtrimin e veprimtarise se institucionit me qellim rivleresimin kalimtar te gjykatesve dhe prokuroreve, ne kohe dhe cilesi.						Qellimi I ketij programi do te realizohet ne vazhdimesi me plotesimin e strukturave te administrates dhe realizimin e te gjithe procedurave te prokurimit per krijimin e infrastruktures se nevojshme per veprimtarine vjetore te institucionit
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2017	Niveli i planifikuar ne vitin 2018	Niveli i rishikuar per 4 mujorin e pare te vitit 2018	Niveli faktik per 4 mujorin e pare te vitit 2018	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te rregullt ligjor, transparences dhe frymes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera.								
	Tregues i Performances nr.1: Respektimi i Afateve ligjore gjate ushtrimit te kompetencave te ankimit ndaj vendimeve te KPK-se, respektimi i parimit te procesit te rregullt ligjor dhe transparent.	A			1	1	1	100%	

Nëpunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Nëpunësi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	13.6.2018		Data	13.6.2018

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Buxheti kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2018	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	3040	2018	2018		3040				Projektet do te realizohen ne 4 mujorin e dyte 2018 dhe ne vazhdim. Cngurtesimi I fondit te investimeve eshte bere ne maj 2018
M630013	Pajisje elektronike	960	2018	2018		960				-
M630021	Software I menaxhimit te ceshetjeve	2200	2018	2018		2200				-
M630022	Software aktiviteti financiar	300	2018	2018		300				-
M630020	Automjet	2500	2018	2018		2500				-
	TOTALI	9000				9000				-

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/	Vlera e plotë	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Buxheti kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2018	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente

Nëpunësi Zbatues	Emri	Aqelina Kastrati	Nëpunësi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma	<i>[Firma]</i>		Firma	<i>[Firma]</i>
	Data	17.6.2018		Data	15.6.2018